




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-30276/22 datë: 24.10.2022



Npi – 01/350 datë: 27.10.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.10.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 27.10.2022 (e enjte) në ora 14:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kan marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, znj.Valmira Hoxha, praktikante, dhe z.Shqiprim Hyseni.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.09.2022,
2. Raport nëntëmujor Buxhetor Janar-Shtator 2022,
3. Propozim-Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2023,
4. Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes,
5. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale Nr752/0, Z.K – Carralevë,
6. Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve,
7. Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.09.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Në vazhdim konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 29.08.2022.**

Pika 2

Raport nëntëmuajor Buxhetor Janar-Shtator 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përshëndetje, ju njoftojë që raporti bëhet sipas ligjit. Ky raport përfshinë të hyrat dhe donacionet Janar-Shtator (shih dokumentin). Të hyra kemi pasur 462.504.31 euro 87% ku është 12% më i lartë se vitin paraprak. Të hyra nga licencat kemi, 4878.52 euro (shih dokumentin) vazhdoj me lexuar dokumentin. Po ju njoftoj shkurtimisht 52% është shpenzuar Buxheti i Komunës. Por ato çka janë në proces nuk i raportojmë, granti qeveritar 55.58% janë shpenzuar (shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Te kredia sa për qind të investimeve kapitale janë realizuar dhe te Zyra e Kryetarit të Komunës. Me na e pru një pasqyrë më të thuktë të shpenzimeve të zyra e Kryetarit.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; nga shuma që e kemi pasur për këtë vit është 51.32%. Investime kapitale me 31.32%, nga granti qeveritar. Zyra e Kryetarit ka pasur paga mëditje në tabelën nr. 9 shihet 45.97%, pagesat i menaxhon Ministria. Mundem nëse kërkon me ju raportuar edhe më hollësisht.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, i kërkoj zyrtarit financiar që me na e dërguar në e-mail për me bërë një krahasim të investimeve kapitale 2020, dhe raportit të prezantuar sot.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Sot e kemi këtë raport, por mundemi edhe zyrtarisht të ju njoftojmë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; është mirë me pyet edhe për këtë Kuvend qysh kanë qenë shifrat e buxhetit e si janë sot.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Sa i përket realizimit të buxhetit do të realizohen këto shifra dhe do të ndryshojnë deri në fundvit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është mirë me cek se sa janë të zotuar, se kam informacion që e kalon 65%, dhe ka shumë projekte që janë në realizim e sipër.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; U ktheva mbas diskutimit që tha doktor Përparimi, kryesisht varet nga drejtori për me realizuar atë buxhet, 400 mijë janë pa zotuar.

z.Kadri Emini; Mos shpenzimi i buxhetit është shqetësues, por nuk e ka vetëm Komuna e Shtimes, kjo është për shkak të ndryshimit të madh të çmimeve, e për këtë shumë Operator po hezitojnë me marr projekte të reja por edhe me i realizuar ato që i kanë.

z.Lumni Amrushi; është një paqartësi, që nuk janë tenderuar edhe ato projekte. Kontratat e vitit paraprak, është dashtë projektet me filluar në muajin Mars ende nuk kanë filluar edhe në këtë kohë kur po flasim.

z.Përparim Ramusa; U përmenden Operatorët, ka projekte dy vjeçare që u kanë dashtë në muajin Mars me u krye, sa kanë qen tjera çmime, ne s'mundemi me votuar këtë raport.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Në mbledhje të Kuvendit drejtorët kompetent do t'ju japin ecurit e shpenzimeve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Përveç që duhet të votohet duhet të kemi edhe rekomandim, kisha propozuar që edhe Drejtori i DSHP-së, drejtori i DPUGJK-së edhe ai Prokurimit të jenë në mbledhjen e Kuvendit për të dhënë sqarime.

z.Përparim Ramusa; Ti si Kryesues e ke për obligim me hedh në votim, na e votojmë kundër.

znj.Adelina Beqaj; Sa i përket këtij raporti Bujari raporton statistikat na nuk jemi të kënaqur me këtë raport.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Këtë raport duhet me votuar, kërkesa jonë është për drejtorët që me na ofruar argumente tjera.

znj.Adelina Beqaj; Ne kemi edhe raporte tjera, tani vjen raporti tjetër.

z.Lumni Amrushi; Po ndihna keq për Bujarin, por na jemi të pakënaqur me Ekzekutivin. Na po e bëjmë këtë njëherë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** (Me përdorimin e votës së dyfishtë të Kryesuesit sipas nenit 48.1 të LVL Nr.03/L-040), vendosi ti rekomandoj Kuvendit miratimin e Raportit nëntëmuor buxhetor Janar-Shtator 2022. Me vërejtjen që në mbledhjen e Kuvendit të japin sqarime shtesë për raportin drejtorët e : Prokurimit, Urbanizmit, dhe Shërbimeve Publike.

Pika 3

Propozim-Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Ne kemi punuar me vendimin e më hershëm, u dorëzua në Departament të Tatimit në Pronë dhe na është kthyer, nuk duhet të nxjerrim rregullore, por vetëm të ndryshojmë normat tatimore (shih dokumentin). Unë i sjella para juve normat minimale tatimore me 15% ju mundeni mi ngrit këto, por jo edhe me i ulë më shumë (shih dokumentin).

z.Kadri Emini; Meqenëse edhe në vitin 2022 është zbatuar vendimi i viti 2021, duhet me pas diferencim pak te pronat komerciale.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Nëse thuhet me të njëjtin vendim atëherë duhet me shikua vendimin (shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Pajtona plotësisht me Kadriun. Është fakt që normat të janë me 15% vetëm te njësit Komerciale të Objekteve mund të jen 18% , ti rekomandojmë Kuvendit që ta votojmë kështu.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për caktimin e normave tatimore për vitin 2023, me propozimin që te pika 7. (Njësitë komerciale të objekteve) nga norma tatimore 0.15% të rritet në normën tatimore në 0.18%.**

Pika 4

Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kemi një Rekomandim nga Komisioni për ndryshimin kësaj rregullore. Nëse keni diçka me diskutuar për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Ata si Komision kanë punuar në këtë Draft-Rregullore që ne ti rekomandojmë Kuvendit.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsisht vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregulloren për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes.**

Pika 5

Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale Nr752/0, Z.K – Carralevë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Drejtori, Grejtalbi do të na jep sqarimet lidhur me këtë Propozim-Vendim.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, këtu bëhet fjalë për hyrjen në Shkollën fillore “Avdullah Shabani” të fshatit Carralevë. Te hyrja e Shkollës është e rëndësishme se nuk ka qasje tjetër me hy në këtë Shkollë. Pronari e ka hap një kanal, ku e ka pamundësuar kalimin e druve, kjo është pse e kemi bërë këtë Propozim-Vendim.

z.Përparim Ramusa; Pajtona të bëhet ky shpronësim, kemi shpronësuar dy hektar pa asnjë centë në gjep mbase është për interes të Shkollës ti rekomandojmë Kuvendit.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm, Ngastrën Kadastrale Nr.752/0, Z.K – Carralevë.**

Pika 6

Propozim – Vendim për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapë diskutimin për këtë pikë tha, rregullorja e punës së Kuvendit duhet të ndryshohet, duhet të ketë një Komision për këtë. Në mbledhjen kaluar është votuar të ndryshohet vetëm neni 3.5, e kam pa të arsyeshme që ta formojmë një Komision.

z.Përparim Ramusa; Pajtona me këtë Propozim-Vendim, duhet të ndryshohet rregullorja e Kuvendit. Pse dy me dy në Komision a mos është kanë e udhës me kanë 3 nga Kuvendi me 1 nga ekzekutivi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Jam konsultuar edhe me MAPL-në, edhe te vendimi i fundit ka qenë kjo formë, shoqëria civile e përmbush këtë gjë. Po kemi probleme me këto Komisione, sepse po propozohen e mandej nuk po kanë kohë me marr pjesë nëpër mbledhje, prandaj kam propozuar që dy të jenë nga Ekzekutivi. Në këto Komisione kur nuk po paguhen po hezitojnë me marr pjesë. Ata si Komision e hartojnë draftin e na e votojmë, jashtë ligjit s'munden me dal edhe ata. Jam që të jetë një rregullore e mirëfilltë që do t'ju shërben edhe në të ardhmen Asamblesë Komunale.

z.Përparim Ramusa; Në Kuvend na e propozojmë që ti me qenë pjesë e këtij Komisioni.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dy anëtar të Komisionit do të jenë nga Ekzekutivi, mirë është me qenë të gjithë juristë, që me nxjerr një rregullore që i ka hije Kuvendit, po ju them që në të gjitha mbledhjet e këtij, Komisioni do të jem prezent edhe unë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për formimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, sipas propozim-vendimit të Ekzekutivit Nr.02/649 të datës 24.10.2022.**

Pika 7

Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Është dashtë që Zyrtarja për Informim me qenë këtu për elaborim. E kisha be si vërejtje për drejtoreshën e KAKRS dhe zyrtaren për Informim edhe pse janë të liruara nga puna pasi që janë Lehona, por po duket pa përgjegjësi e ekzekutivit që po vazhdojnë me ardhur në punë edhe për kundër pushimit që ju takon. Kryesues pajtona me këtë pjesë se është pjesë e ekzekutivit.

z.Përparim Ramusa; Mbase ka me pas në Kuvend debat dhe sqarime për këtë pikë duhet ta votojmë si Rekomandim për Kuvendin. Me arsyetimin se Zyrtarja apo dikush nga Ekzekutivi të na jap sqarime për këtë Draft-Strategji.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, me propozimin që në mbledhjen e Kuvendit të na jep sqarime shtesë përfaqësuesi i Zyrës për Informim.**

Pasi diskutime të tjera nuk pati Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:45

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi